VENDIM
Nr.19, datë 14.2.2008

PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË SHËRBIMIT TË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR PERIUDHËN 1 MARS 2008 – 28 SHKURT 2009

Në mbështetje të neneve 8 pika 2, germa "b", 9, 26, pika 1, 27, dhe 28 të ligjit nr9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.59, datë 29.12.2004 "Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike" Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 14.2.2008, pasi shqyrtoi dhe analizoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria OST sh.a., për miratimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike,

VENDOSI:

1. Tarifa për shërbimin e transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 1 mars 2008 – 28 shkurt 2009 është 0.50 lekë/kWh.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kryetari i Ere-s
Bujar Nepravishta